



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 88

Prishtinë, më 17.9.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Jetmire Vrenezi, Albena Reshitaj dhe Samra Ilijazi.

Munguan: Besian Mustafa, Salih Zyba dhe Ganimete Musliu.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 2.7.2024;
3. Miratimi i Raportit të punës për sesionin pranveror 2024;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-312 për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
5. Shqyrtimi i përfundimit nga Kryesia e Kuvendit rreth raportit me rekomandime të Komisionit, në lidhje me të gjeturat për tjetërsimin e pronës së RTP dhe Fakultetit Teknik;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja e Komisionit kërkoi që të plotësohet rendi i ditës, pas pikës 5 të shtohet: “6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-315 për banim social dhe të përbalueshëm”. Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi këtë propozim dhe e miratoi rendin e ditës, me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 2.7.2024

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, e miratoi procesverbalin nga dt. 2.7.2024.

3. Miratimi i Raportit të punës për sesionin pranveror 2024

Kryetarja e paraqiti raportin për diskutim dhe tha se ky raport është përgatitur me qëllim të pasqyrimin të punës së komisionit për sesionin pranveror të vitit 2024, i cili përmban të dhënat që tregojnë për aktivitetet e zhvilluara dhe realizimin e objektivave të planit të punës për këtë sesion.

Gjatë sesionit pranveror 2024, komisioni ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 28 mbledhje të grupeve punuese, një dëgjim publik, tri tryeza dhe punëtori dhe ka realizuar disa vizita në institucione publike dhe private. Komisioni, gjatë sesionit pranveror 2024, ka pasur në shqyrtim 12 projektligje, 3 prej tyre janë miratuar në lexim të dytë, përfshirë këtu një marrëveshje ndërkombëtare, 1 është në pritje për lexim të dytë në seancë, 2 janë në pritje në seancë për miratim në parim dhe 6 projektligje janë në procedurë të shqyrtimit në komision.

Gjatë këtij sesioni, nga Kuvendi janë miratuar ligje të rëndësishme: Ligji për rregullat e trafikut rrugor; Ligji për verërat; Ligji për performancën energjetike të ndërtesave; Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëfinancimit për hartimin e projektit për ndërtimin e tunelit në rrugën Tetovë-Prizren.

Në procedurë të shqyrtimit në komision janë projektligjet të rëndësishme, siç janë: Projektligji për rrugët; për administrimin e ndërtesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi; për vlerësimin strategjik mjedisor; për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror; për faturat e kulturave bujqësore dhe fletë magazinave; për menaxhimin e resurseve ujore; për shpronësimin e pronës së paluajtshme, etj.

Gjithashtu, gjatë këtij sesioni janë zhvilluar vizita, takime dhe aktivitete të tjera nga kryetarja dhe anëtarët e komisionit. Mbledhjet e komisionit kanë qenë të hapura dhe janë përcjellë nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe të interesuar të tjerë. Ndërsa, në grupet punuese kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga ministritë përkatëse, ekspertë të pavarur, organizatat mbështetëse të punës së komisionit, etj.

Ajo përfundoi se, kjo është një përmbledhje e aktiviteteve, nëse nuk ka dikush të shtojë diçka, apo ndonjë aktivitet tjetër që duhet të shtohet në këtë raport, mund ta dërgojnë me shkrim, me qëllim që raporti të plotësohet.

Pasi që nuk pati diskutues, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, nxori këtë

Përfundim:

Miratohet Raporti i punës për sesionin pranveror 2024.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-312 për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim projektligjin dhe tha se projektligj është nismë e 6 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, i ka 10 nene dhe qëllimi i tij është “mbrojtja e shëndetit të personave nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nga efektet negative të pijeve energjike, përmes edukimit, ndërgjegjësimin, mbrojtjes nga rreziku i ekspozimit dhe përdorimit, kontrollit, prodhimit, tregimit dhe kufizimit të reklamimit të këtyre produkteve”.

Pastaj shtoi se kjo nismë e deputetëve, sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Rregullores, i është dërguar Qeverisë për mendim, ndërsa ajo nuk ka paraqitur mendimin. Ndërsa, sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Drejtoria e Buxhetit të Kuvendit, projektligji nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore. Sipas opinionit ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nga Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit, dispozitat e këtij projektligji nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit primar dhe sekondar të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

Pasi që nuk kishte diskutues, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-312 për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

5. Shqyrtimi i përfundimit nga Kryesia e Kuvendit rreth raportit me rekomandime të Komisionit, në lidhje me të gjeturat për tjetërsimin e pronës së RTP dhe Fakultetit Teknik

Kryetarja, tha se Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 14.5.2024, pasi i shqyrtoi raportet për pronën e tjetërsuar të RTP-së dhe të Fakultetit Teknik, vendosi që raportet me të gjetura, të përcillen në Kryesinë e Kuvendit, e cila do të shqyrtojë solucionin e përshtatshëm: Debat parlamentar, Komision hetimor ose dërgimi në Prokurorinë kompetente. Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 9.9.2024, nxori:

“Përfundim

Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim , i kthehet raporti me rekomandime, në lidhje me të gjeturat rreth tjetërsimit të pronës së RTP-së dhe të Fakultetit Teknik, pasi që nuk i plotëson kushtet formale për procedimin e tij në Seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

Pasi pyeti për propozimet në lidhje me këtë temë, sesi të veprohet më tutje, ia dha fjalën deputetit Milazim Salijaj, i cili e ka udhëhequr përgatitjen e këtyre raporteve.

Milazim Salijaj, tha se si komision e kemi kryer punën dhe për këto dy raste kemi përpiluar dy raporte mjaft të detajuara, dhe pasi që Kryesia e Kuvendit e ka dhënë mendimin e vet, unë jam i mendimit që ne si Komision duhet të vendosim që këto dy raste duhet të dërgohen në Prokurorinë e Shtetit.

Kryetarja, tha se pajtohem me propozimin e deputetit Salijaj, sepse ne i kemi shterur të gjitha rrugët tjera dhe kjo çështje duhet t'i dërgohet prokurorisë, që ata të vendosin, sepse është problem pronësor.

Pasi që nuk kishte diskutues dhe propozime të tjera, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë

Përfundim:

Raportet me të gjeturat për pronën e tjetërsuar të RTP-së dhe të Fakultetit Teknik, vendosi t'i dërgojë në Prokurorinë e Shtetit.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-315 për banim social dhe të përbalueshëm

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim projektligjin dhe tha se ky projektligj ka 45 nene dhe ka për qëllim krijimin e programeve të banimit për të gjithë, përmes përcaktimit të rregullave, procedurave të planifikimit, administrimit, zbatimit dhe shpërndarjes së programeve, si dhe përcaktimin e kriterëve të provueshmërisë dhe mundësive të përfitimit nga programet e banimit për familjet dhe individët në nevojë.

Pastaj shtoi se sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave, projektligji do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumën prej 12,468,702 euro, për vitet 2025-2026, si dhe shtim të numrit të punëtorëve për 9 pozita të reja. Këto mjete dhe pozita nuk janë të parapara me Ligjin nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024 dhe Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2025-2027. Rrjedhimisht, kjo është kosto shtesë për institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji, siç janë komunat, në shumë prej 12,260,000 euro për vitet 2025-2026 dhe për MMPHI-në, përkatësisht Agjencinë për Banim të Kosovës, është në shumën prej 208,702 euro, si dhe 9 pozita të reja për vitet 2025-2026.

Ndërsa, sipas opinionit ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, dispozitat e projektligjit synojnë fushëveprimin e rregullimit social përmes përfshirjes së politikave që rrjedhin nga parimet e buta të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

Isak Shabani, tha ky projektligj është i nevojshëm, e di se gjatë fushatës kryeministri ka premtuar shumë banesa dhe mundësi për banim të përballueshëm, mirëpo tash po bie një kontrast, derisa sot na vjen një projektligj për t'u miratuar. Në anën tjetër, këto ditë kemi parë se ministri i MMPHI-së ka nënshkruar marrëveshje me disa komuna për banim të përballueshëm. Pyeti: si ka mundur ai t'i nënshkruajë këto marrëveshje ende pa qenë ligji në fuqi?

Kryetarja u përgjigj se marrëveshjet që po i bën ministri me komuna nuk përfshihen në këtë ligj. Ligji e rregullon mënyrën se si do të shpërndahen banesat, kriteret se kush do t'i marrë banesat. Pra, kur t'i kemi gati banesat, të ndërtuara, ligji shërben për të bërë ndarjen e tyre. Tash janë marrëveshjet e nënshkruara me 5 komuna. Problemi që komunat deri më tash nuk kanë filluar të ndërtojnë, ishte mungesa e gjetjes së pronave për ndërtim nga ana e tyre.

Pas diskutimeve, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji nr.08/L-315 për banim social dhe të përballueshëm

7. Të ndryshme

- Komisioni nxori vendimin për formimin e grupit të punës për Projektligjin nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror, në këtë përbërje: *Ekrem Mustafa- kryesues, Jetmire Vrenezi dhe Isak Shabani, anëtarë.*
- Komisioni u dakordua që nesër, më 18.9.2024, të realizojë një vizitë në Ujman, së bashku me përfaqësuesit e NP "Ibër Lepenci". Vizita bëhet në kuadër të monitorimit të Ligjit të ujërave, të cilin e udhëheq deputetja Albena Reshitaj dhe ftoi deputetët të konfirmojnë pjesëmarrjen.
- *Kryetarja* njoftoi për takimin që Komisioni për Mjedis dhe ai për Ekonomi, kanë pasur me ministren Gjermane për Evropën dhe Klimën. Në takim nga Komisioni për Mjedis kam qenë unë dhe deputeti Milazim Salijaj, ndërsa tema ka qenë për klimë dhe investimet e mundshme të Gjermanisë në Kosovë, për klimë dhe energji.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit